



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT



Shërbimi Këshillimor Bujqësor Rural i Kosovës
Kosovo Agriculture and Rural Development Advisory Services
Poljoprivredna Ruralna Savetodavna Služba Kosova

Njoftim për Procesin e Certifikimit të kandidatëve për Këshilltarë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural

Departamenti për Shërbime Këshilluese dhe Teknike (DSHKT), në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-074 për Shërbime Këshillimore në Bujqësi dhe Zhvillim Rural si dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 07/2015, ka zhvilluar me sukses procesin e certifikimit të kandidatëve për Këshilltarë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural gjatë muajit mars 2025.

Ky proces ka përfshirë disa faza të rëndësishme:

1. Aplikimi – Pas publikimit të ftesës për aplikim, nga numri i përgjithshëm i aplikantëve, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të dorëzuar, **vetëm 56 kandidatë** kanë plotësuar kushtet për të vazhduar me fazat e mëtejshme të certifikimit.

2. Trajnimi – Kandidatët e kualifikuar kanë ndjekur trajnime intensive, të organizuara në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës. Trajnimet kanë përfshirë **pesë module kryesore**, të cilat kanë synuar zhvillimin profesional të kandidatëve dhe aftësimin e tyre për të ofruar shërbime cilësore për fermerët dhe komunitetet rurale. Modulet e trajtimit kanë qenë:

- **Moduli 1:** Njohuritë Bazë (2 ditë)
- **Moduli 2:** Menaxhimi i Kohës (1 ditë)
- **Moduli 3:** Metodologjia dhe Aftësitë Ndërpersonale (2 ditë)
- **Moduli 4:** Metodatat e Dhënies së Këshillave (2 ditë)
- **Moduli 5:** Menaxhimi i Fermës (3 ditë)



Trajnimet janë zhvilluar në mënyrë të kombinuar, duke përfshirë sesione teorike dhe praktike, me qëllim që kandidatët të fitojnë njohuri shtesë dhe t'i aplikojnë ato në situata reale të punës.

3. Testimi – Testi me shkrim është mbajtur në përputhje me kriteret e përcaktuara në Udhëzimin Administrativ dhe nën mbikëqyrjen e stafit të DSHKT-së. Pas vlerësimit të testeve nga Komisioni për Vlerësim dhe Certifikim, **51 kandidatë** kanë kaluar me sukses provimin dhe janë certifikuar si **Këshilltarë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural**.



4. Publikimi i rezultateve – Në përfundim të procesit të certifikimit, janë publikuar rezultatet, dhe janë njoftuar këshilltarët që kanë kaluar me sukses testin. Këshilltarët e certifikuar janë pajisur me certifikata dhe kanë hyrë në regjistrin e këshilltarëve të certifikuar. Lista me këshilltarët e certifikuar do të jetë publike, duke respektuar parimet e transparencës dhe të mbrojtjes së të dhënave personale të aplikantëve njëhënjë duke respektuar udhëzimin administrativ nr. 09/2015 për formën, përmbajtjen dhe procedurat e mirëmbajtjes së regjistrit për ofruesit e shërbimeve këshilluese në bujqësi dhe zhvillim rural..



Ky proces i certifikimit synon forcimin e kapaciteteve profesionale të shërbimit këshillues publik dhe privat, si dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve për fermerët në përputhje me standardet bashkëkohore dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, si dhe forcimin e **Sistemit Këshillues të Kosovës për Bujqësi dhe Zhvillim Rural**.

Për më shumë informacione, ju lutemi kontaktoni:

Departamenti për Shërbime Këshilluese dhe Teknike (DSHKT)
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Rr. "Ukshin Hoti", ndërtesa e ish Ramiz Sadikut, nr 120 Kati III, Prishtinë – Kosova
Tel. 383- (0)3820038426